



Prishtinë, 27.01.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1671_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2377_11_22** i dt.03.11.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 23.11.2022.

në seancën e mbajtur më datë **27.01.2023** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit D.H nga Komuna e Gjakovës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2377_11_22 i dt.03.11.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 03.11.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2377_11_22 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 09.09.2022 lidhur me kontestimin e faturës per periudhën qershor 2015 si dhe korrigjimit plotësues nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 9135931.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, pala Drin Hoda, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se fatura nr. 06150DGJ-9028143 datë 25.06.2015 dhe korrigjimi nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015 nuk mund të jenë reale;
- Pala kërkon nga Bordi që të shqyrtoj ankesën në kohë dhe të merr vendim të drejtë si dhe të mundësoj kohëzgjatje me te madhe te pagesës.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimin se fatura nr. 06150DGJ-9028143 datë 25.06.2015 dhe korrëgjimi nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015 nuk është i saktë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0205003 datë 24.04.2015; Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.Org.02.Nr.7348 datë 23.06.2015; Fatura nr. 06150DGJ-9028143 datë 25.06.2015 dhe korrëgjimi nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015; Përgjigja e KESCO-s datë datës 09.09.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 29.09.2022; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2377_11_22 i dt.03.11.2022, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike si dhe listat e leximi gjeti se faturimi i kWh ne faturën nr. 06150DGJ-9028143 datë 25.06.2015 dhe korrëgjimi nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015 nuk është i saktë, andaj nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRRE ka vërejtur se, me datë 24.04.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 9135931 me gjendje TL=109820 kWh dhe TU= 002740 kWh si dhe kanë vendosur per matje njehsorin elektrik nr. 16231312 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. DMK ka analizuar procesverbalin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik dhe konstaton se te dhënat e shpenzimeve te regjistruar ne procesverbal nuk përputhën me te dhënat e regjistruara dhe faturuara ne CPP. Sipas te dhënave te fundit te evidentuar dhe faturuar ne CCP per periudhën prill 2015 gjendja e shpenzimeve është: TL=11876 kWh dhe TU=9075 kWh, me çka vërtetohet se konsumatori nuk ka pasur faturim te saktë e qe kjo eshte ne kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar faturën nr. 0622285785DPR-90167690 date 21.06.2022 dhe konstaton se kjo fature paraqet kWh te grumbulluar dhe se ne asnjë rast nuk mund te paraqet shpenzim real mujor te konsumatorit. Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 05.09.2022 përmes korrëgjimit nr. 100559DPR-90167690 ka bere korrëgjimin në vlerë **-2,938.24 €** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën katër mujore, periudhën 02/2022 deri ne periudhën 05/2022 per shkak te faturimit jo te saktë. ZRRE duke marr per baze edhe kërkesën per lidhje te re 22.09.2020 si dhe shpenzimet e konsumatorit ka bere shpërndarjen e këtyre kWh per periudhën 09/2020 deri ne periudhën 05/2022 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrëgjim tjetër financiar. Po ashtu sipas korrëgjimit te bere nga Departamenti i faturimit vërtetohet se kWh e regjistruar ne listën e leximit te datës 21.01.2022 nuk janë faturuar me strukturën e re tarifore por vetëm diferenca e kWh pas regjistrimit te njehsorit nr. 20058382(TL=7,377 kWh dhe TU=7,479 kWh). ZRRE ka shqyrtuar korrëgjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrëgjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese. Bordi i ZRRE po ashtu ka shqyrtuar procesverbalin e datës 23.06.2015, ku punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 9135931 me gjendje të shpenzimeve TL=109827 kWh dhe TU=002747 kWh ku kanë konstatuar se : njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe ne brendi komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit për periudhën kontestuese dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim te rregullta mujore dhe se në shumicën e periudhave



ka evidentuar qe nuk ka qasje ne leximin e njehsorit elektrik si dhe ne periudhën 05/06/2015 ka evidentuar se njehsori ka numër tjetër serik. Bazuar ne rrjedhën e energjisë elektrike si dhe krahasimin me periudha te njëjta kohore vërtetohet se shpenzimi i faturuar ne periudhën 06/2015 nuk përputhët edhe me shpenzimet e me hershme apo edhe te me vonshme dhe se nuk paraqet shpenzim real te konsumatorit por qe paraqet grumbullim te kWh per shkak te mos faturimit te saktë te shpenzimeve mujore. Po ashtu vërtetohet se konsumatori nga fillimi deri ne ndërrimin e njehsorit elektrik nuk ka lexim te saktë te shpenzimeve te energjisë elektrike por qe per këto periudha është faturuar pa matje. Mos qasja ne leximin e shpenzimeve mujore është ne kundërshtim me nenit 25 paragrafit 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji

Bordi i ZRRE po ashtu konstatoi se Departamenti i faturimit në KESCO me datë 25.06.2015 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën qershor 2015 me **49,999 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **4,125.32€** si dhe me datë 01.07.2015 përmes korrigjimit nr. 061573556DGJ-9028143 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimin plotësues në vlerë **4,144.25€**. Bordi ka shqyrtuar faturën e periudhës qershor 2015 dhe korrigjimin nr. 061573556DGJ-9028143 datë 01.07.2015 dhe konstaton se ne faturën e periudhës qershor 2015 konsumatori është faturuar vetëm ne tarifën e lartë me **49,999 kWh** kurse përmes korrigjimit plotësues nr. 061573556DGJ-9028143 i janë faturuar konsumatorit ne tarifën e larte edhe **TL=47945 kWh** kurse i janë minisuar nga faturimi i mëhershëm ne tarifën e ulet **TL=-6335 kWh**. ZRRE konstaton se KESCO ka gabuar pasi qe faturimi i periudhës qershor 2015 nuk mund te paraqet shpenzim real te konsumatorit si dhe korrigjimi nr. 061573556DGJ-9028143 i datës 01.07.2015 po ashtu ka përfshirë ndryshimin e kWh ne tarifën e lartë nga ata te faturuar ne periudhën 06/2015 dhe procesverbalit mbi ndërrimin e njehsorit elektrik. Bazuar ne shqyrtimet e bëra si dhe rrjedhën e energjisë elektrike nga fillimi përkatësisht periudha 09/2010 deri ne periudhën e ndërrimit te njehsorit elektrik datë 24.04.2015 vërtetohet se konsumatori nga periudha 10/2010 nuk ka faturim te saktë andaj KESCO është dashur qe korrigjimin e faturimit ta bëjë nga periudha 10/2010 deri në periudhën 04/2015(datë 24.04.2015) në vlerë **+7567.23€**

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0205003 datë 24.04.2015, procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.Org.02.Nr.7348 datë 23.06.2015, listat e leximit si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga



data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit D.H dhe
- Arkivit të ZRRE-së.